



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2205 Prot.

Lezhë, më 16 . 02 . 2026

VENDIM

Nr. 12, Datë 16. 02. 2026

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I BANESAVE  
EKZISTUESE PËR FAMILJE” PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.06.2023, VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfiturar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM nr. 454, datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese, si dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Lezhë Nr. 1964/1 prot., datë 10.02.2026, “Për miratimin e listës së familjeve përfituese në parim të projektit “Përmirësimi i banesave ekzistuese për familje” për vitin 2026”, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

- I. Të miratojë në parim listën e familjeve që përfitojnë nga projekti “Për përmirësimin e banesave ekzistuese për familjet” për vitin 2026, me numër rendor 17, sipas tabelës nr. 4 bashkëlidhur dhe pjesë e pandashme e këtij vendimi.
- II. Për zbatimin të këtij vendimi, Bashkia Lezhë t'i paraqesë kërkesën për aplikim, për projektin “Përmirësimi i banesave ekzistuese për familje”, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, brenda datës 16 shkurt 2026.
- III. Bashkia Lezhë angazhohet për bashkëfinancim në masën 50% të vlerës së projektit me fondet e saj.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- V. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUEJ LULI

